



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# STUDIMI DHE KËNDIMI I KUR'ANIT

## Ibrahim Trebinjac

Botuar nga: Botues Privat

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit: Basri Iljazi

Fjala e përkthyesit .....	5
1. Rëndësia e studimit dhe këndimit të Kur'anit.....	6
2. Gjunah është të harrosh diçka prej tekstit të mësuar përmendësh nga Kur'ani .....	16
3. Pastrimi para se të këndohet Kur'an .....	18
4. Ku dhe në çfarë pozitë këndohet Kur'ani?.....	19
5. Të shqiptuarit e fjalës "amin"!.....	20
6. Kur është mirë të ulin zërin gjatë këndimit të Kur'anit?.....	20
7. Përsëritja gjatë këndimit.....	21
8. Të kërkosh që tjetri të këndoje Kur'an .....	21
9. Të kunduarit e Kur'anit me radhë .....	21
10. Të dëgjuarit e këndimit të Kur'anit.....	22
11. Sexhdeja pas këndimit të Kur'anit.....	23
12. Koha e këndimit të Kur'anit.....	24
13. Koha e fillimit dhe përfundimit të këndimit të Kur'anit .....	25
15. Tekbiri pas këndimit të disa sureve .....	26
16. Duaja e hatmes.....	27
17. Pas përfundimit të njëres, fillimi i hatmes tjetër .....	27
18. Ndërprerja dhe vazhdimi i këndimit të Kur'anit përsëri .....	28
19 Këndimi i sures IHLAS tri herë .....	28
20. Për sa kohë duhet të këndohet Kur'ani?.....	29

21. Sevapi nga këndimi i Kur'anit për të vdekurit.....	31
22. Kur'ani si burim i të ardhurave për jetesë.....	31
23. Pranimi i dhuratës për të mësuarit e Kur'anit të tjerëve .....	32
24. Mënyrat e ndryshme të respektimit të Mus'hafit .....	32
25. Shitblerja e Mus'hafit .....	34
26. Me çfarë shpejtësie të këndohet Kur'an? .....	34
27. Me çfarë shpejtësie kanë kënduar disa nga ekspertët e njohur të kiraetit? .....	35
28. Sa të këndohet nga Mus'hafi? .....	36
29. Këndimi i Kur'anit me zë dhe në vete.....	38
30. Të kënduarit nga Mus'hafi .....	38
31. Istiadha .....	39
32. A duhet istiadha të shqiptohet me zë ose në vete? .....	40
33. Ndarja, përkatësisht ngjitja e istiadhës me tekstin që vijon.....	41
34. A është shqiptimi i istiadhës i rekomanduar apo është i domosdoshëm?.....	42
35. Bismil-lahu .....	42

## FJALA E PËRKTHYESIT

Kur'ani është libër i All-llahut. Shumë ibadete nuk mund të kryhen pa lexuar pjesë nga Kur'ani. Përveç kësaj, edhe vetë leximi, apo këndimi i Kur'anit është një ndër ibadetet më të çmuara te All-llahu xh.sh.

Ky ibadet i ka rregullat e veta se si duhet të kryhet, duke përfshirë këtu: lartësinë e zërit gjatë këndimit, pozitën në të cilën jemi, momentin më të përshtatshëm për të kënduar, si duhet ta dëgjojmë kur këndon tjetër kush, a mund të këndojmë për të tjerët e etj.

Poashtu edhe ndaj Kur'anit si libër i shenjtë, duhet të dimë se si të sillemi e ta ruajmë atë; si të tregojmë respektin e duhur ndaj librit më të çmuar që e kemi në shtëpitë tona; si duhet ta marrim nëpër duar, si duhet ta shfletojmë etj. Mendoj se njohja e rregullave se si duhet të sillemi ndaj Kur'anit, si libër i shpallur nga All-llahu xh.sh., nuk duhet të jetë privilegj vetëm i njerëzve të cilët merren me thirrjen dhe edukimin në fenë islame, por duhet të depërtojë në masën e gjërë të besimtarëve, gjegjësisht te të gjithë ata që dinë të këndojnë Kur'anin dhe dëshirojnë të dinë sa më shumë për të.

Duke parë shprazëtinë që ekziston për këtë lloj literature në gjuhën shqipe, vendosa ta përkthej këtë punim të profesorit të nderuar nga Sarajeva, rahmetli Ibrahim ef. Trebinjac, i cili në

mbarështrimin e këtij punimi ka shfrytëzuar njohuritë e dijetarëve të gjeneratave të hershme që janë marrë me këtë çështje.

Në fund lus All-llahun xh.sh. që t'i shpërblejë me të mira të gjitha ata që më dhanë kurajo që ky punim të shohë dritën e botimit në gjuhën shqipe.

Falendërimi dhe lavdërimi i takon vetëm All-llahut xh.sh.

Përkthyesi

## **1. RËNDËSIA E STUDIMIT DHE KËNDIMIT TË KUR'ANIT**

Kur'ani është burimi kryesor dhe i parë i Islamit, ligji themelor i gjithë muslimanëve në tërë botën dhe për të gjitha kohët. Shpallja Hyjnorë është, pra, boshti i Islamit, pikënisja e tij, pasqyre dhe pikëmbështetje. Prandaj, s'është kurrëfarë çudie pse muslimanët e arsimuar kanë dhënë shumë mund dhe kanë shkruar vepra të shumta që Kur'anin ta prezantojnë në shkëlqimin e tij të plotë, që njerëzve t'ua bëjnë më të qartë e më të kuptueshëm. Falë kujdesit dhe dashurisë së madhe të njerëzve, të cilët janë dalluar me kujdesin e tyre për ardhmëri më të mirë e më të lumtur të mbarë njerëzimit, Kur'ani qysh prej paraqitjes së tij, është ruajtur në frymën e tij origjinale.

Dëshira dhe kujdesi i shumë njerëzve që Kur'ani të jetë sa më afër njerëzve, mendjes së tyre, por edhe zemrës bëri që ai jo vetëm të studiohet, por edhe të shqiptohet drejt çdo shkronjë e tij, çdo fjalë dhe fjali, duke e ruajtur edhe anën melodike të tij.

Personi i parë i cili tërë jetën e vet është kujdesur që vlera e Kur'anit, si shpallje e fundit Hyjnore, të shpjegohet qartë dhe drejtë, ka qenë Muhammedi a.s. të cilit, siç dihet edhe i është shpallur Kur'ani. Hadithe të shumta, të cilët kanë të bëjnë me leximin dhe studimin e Kur'anit, konfirmojnë se Pejgamberi i fundit ka dashur të përqëndrojë vëmendjen e gjithë muslimanëve në rëndësinë e madhe të asaj mjeshtërie, e cila duhet të bëhet pjesë përbërëse e jetës së tyre të përditshme.

Ekspoza e ardhshme ka për detyrë t'i shtrojë dhe t'i shpjegojë vetëm disa hadithe të tilla:

"Kush e këndon Kur'anin me saktësi, bën pjesë në shoqërinë e melekëve të ndershëm dhe të mirë, ndërsa ai që gjatë tij (këndimit) belbëzon dhe e lexon me mundim, për këtë ka dy dhurata. Dhurata është sipas masës së angazhimit".

Në këtë hadith Pejgamberi a.s. përmend dy kategori të recituesve të Kur'anit: ata të shkathtit të cilët këndojnë rrjedhshëm, dhe të tjerët të cilëve e këndojnë me vështirësi, sepse ndoshta mirren më rrallë me këtë, dhe gjatë leximit belbëzojnë. Lexues të shkathët të Kur'anit janë ata të cilët e lexojnë me urtësi pa kurrëfarë vështërsie dhe secilën shkronjë, secilën fjalë dhe fjali e shqiptojnë drejtë dhe çiltër, sipas rregullave të gjuhës arabe dhe disiplinës së posaçme të Kur'anit e cila quhet texhvid. Ashtu e ka kënduar Muhammedi a.s. Kur'anin në bazë të shpaljes së pranuar. E ka kënduar me zë, që ta dëgjojnë edhe të tjerët dhe gjithë këtë ta mësojnë. Vetë këndimi i tillë i Kur'anit, që i plotëson kriteret e duhura, u sjell kënduesve vlera të mëdha dhe hyjnë në rradhët e melekëve të ndershëm, që gëzojnë admirimin e Zotit.

Duke e ditur se do të ketë edhe këndues të atillë të Kur'anit të cilëve - edhe përkundër mundit të madh që kanë dhënë - nuk do t'u shkojë për dore që Kur'anin ta këndojnë rrjedhshëm, sipas

rregullave të njohura. Muhammedi a.s. ka shpjeguar të theksojë se edhe leximi i tyre çmohet shumë, dhe i Gjithëhartësuarit edhe ata do t'i shpërblejë për gjithë atë që kanë dhënë në atë drejtim. Ata pra, nuk guxojnë të jenë të pagjindshëm, nuk guxojnë të dekurajohen, pra është e nevojshme të vaxhdojnë me këndimin sepse, sipas rregullës islame, shpërblimi i Zotit vjen sipas mundit të dhënë.

Në hadithin e lartësuar nuk është përmendur kurrëfarë dallimi në mes të kënduesit, i cili e kupton atë që e këndon dhe atij që nuk e kupton. Prej kësaj lehtë mund të përfundojmë se këtu qëllimi kryesor është nxitja e besimtarëve që të shoqërohen me Kur'anin sa më tepër nëpërmjet këndimit, sepse kjo është një prej mënyrave të shumta edhe për mbajtjen e lidhjes me All-llahun xh.sh.

"Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin vetë dhe që ua mëson tjerëve".

Sic duket, kuptimi i këtij hadithi përmban udhëzimin që Kur'anin jo vetëm ta mësojmë ta këndojmë, t'i shqiptojmë drejt fjalët, por edhe ta studiojmë, respektivisht gjithë këtë duhjet ta bartim edhe te të tjerët, sepse kjo nuk guxon të stagnojë, assesi nuk guxon të dobësohet. Vetëm njerëzit e tillë meritojnë të jenë ndër më të mirët. Në këtë normalisht, nuk mund të ketë sukses secili person, mirëpo secila bashkësi islame medoemos të ketë numër të konsiderueshëm njerëzish të tillë, dhe atë në secilën gjeneratë. Mund të thuhet pa e tepruar se kjo është pjesë përbërëse e jetës së vërtetë islame dhe lënia pas dore e këtij obligimi nuk do të mund të arsyetohet me kurgjë.

"Njerëzit më të ndrrshëm ndër pasardhësit e mi janë hafizat e Kur'anit dhe ata të cilët natën i bëjnë ibadet All-llahut xh.sh.".

Me këto fjalë Pejgamberi a.s. jep vlerësimin për njerëzit të cilët e dinë Kur'anin përmendësh, si dhe për ata të cilët i shërbejnë të Lartmadhëruarit në kohën kur këtë rallë kush e bën. Për të dy kategoritë e njerëzve të tillë Muhammedi a.s. thotë se janë të ndershëm, shembullor dhe të dalluar. Ata të tillë janë edhe te i Lartmadhëruari dhe te njerëzit e tjerë. Nga ana e të Lartmadhëruarit ata sigurisht shpërblehen me dhurata, kurse te besimtarët e ndershëm ata janë të respektuar, të çmuar dhe atyre secili mund t'u ketë lakmi.

Në këtë hadith Muhammedi a.s. ka dëshiruar të tërheq vëmendjen e besimtarit në rëndësinë dhe dobinë e shoqërimit me Kur'anin, si dhe në ibadetet për Zotin xh.sh. kur të tjerët flejnë. Ky shërbim në këtë kohë është një prej argumenteve më të qarta të nënshtimit të thellë dhe të sinqert dhe dashurisë ndaj Krijuesit të Madhërishtëm. Ky është një besim i papërshtuar në Zotin dhe në atë se veprat e këtilla dhe gjithë ky flim nuk mund të lihet në harresë, asnjë vepër e mirë në asnjë rast nuk mund të jetë e pashpërblyer.

"Një prej veprave më të dashura te Zoti është këndimi i Kur'anit".

Me një rast tjetër Muhammedi a.s. ka dhënë një deklaratë gati identike kur ka thënë:

"Një prej veprave më të dashura te Zoti për pasardhësit e mi është këndimi i Kur'anit".

Në të dy këto hadithe Pejgamberi a.s. përkujton besimtarin në këndimin e Kur'anit dhe atë për shkak se ky këndim është një prej shumë veprave të mira, përkatësisht prej më të mirave nëpërmjet të cilave njeriu bëhet një prej pasardhësve të mirë të Islamit. Me këndimin e Kur'anit, ai vetëm e rradhit në shoqërinë e të dashurve të Zotit të cilët do të kenë dhurata të begatshme dhe ata janë në kujdesin e posaçëm të Zotit të Lartmadhëruar.

Këto hadithe bëjnë pjesë në deklaratat më të qarta të Pejgamberit a.s. që flasin për rëndësinë dhe vlerën e këndimit të Kur'anit dhe përmbajtja e tyre ofron mundësi që secili besimtar të dëshmohet si njeri i mirë dhe i devotshëm, i cili dëshiron që edhe në këtë mënyrë t'i afrohet Krijuesit dhe të fitojë dashurinë dhe mëshirën e Tij.

"Këto zemra më të vërtetë mund të ndryshken, sikurse ndryshket hekuri kur laget në ujë".

-E si do t'i pastrojmë, o Pejgamber i Zotit?- pyeti dikush.

"Nëse shumë mendojmë për vdekjen dhe nëse këndojmë Kur'an" - u përgjigj Muhammedi a.s.

Në jetën dhe punën e vet secili njeri u është ekspozuar ndikimeve të ndryshme të mjedisit në të cilin jeton, në të cilin lëviz dhe punon, me të cilin komunikon, prej të cilit mvaret. Ato ndikime nuk janë asnjëherë vetëm pozitive, të dobishme, por jo rrallë janë të dëmshme, të kobshme. Ndikimet e dobishme dhe pozitive në shpirtin dhe në zemrën e njeriut nuk janë asnjëherë dhe për askend të tepërta. Ato janë gjithnjë të mirëseardhura, për secilin pa marrë parasysh bile edhe moshën e tij. Ndikimet negative të shoqërisë gjithnjë janë të rrezikshme, sikur të jenë edhe të vogla, të rralla, sikur ne edhe të mos të ishin të vetëdijshëm. Si të tilla, doemos duhet t'iu shmangemi, sepse ato shpesh depërtojnë në shpirtin tonë në mënyrë perfide, por gjithnjë dëmshëm ndikojnë në sjelljen tonë. Ato gradualisht na sundojnë neve, e ndryshojnë moralin tonë, qëndrimin ndaj vetëvetës, sidomos ndaj të tjerëve.

Ndikimet pozitive të shoqërisë duhet gjithnjë t'i kërkojmë dhe t'i çmojmë, kurse atyre negative gjithnjë t'u shmangemi dhe kursesi mos u nënçmojmë. Në këtë angazhim dhe luftë duhet të rrjedhë dhe të përfundojë jeta e secilit besimtar të vërtetë, me bindje të plotë se për vetveten nuk

jemi të mjaftueshëm e as të aftë që të jemi në nivel, të jetojmë dhe të vdesim të drejtë dhe të ngritur. Duhet, poashtu, të jemi të vetëdijshëm se ndikimi negativ i mjedisit gjithnjë është prezent, dhe se forcat tona janë të pamjaftueshme që t'i kundërvihemi me sukses.

Pikërisht atë kuptim kanë fjalët e Pejgamberit a.s.: "këto zemra me të vërtetë mund të ndryshken..." Muhammedi a.s. këtë e paraqet në mënyrë shumë metaforike dhe zemrën e krahason me hekurin, kurse ndikimet e dëmshme me të ndryshkurit nga uji. Kjo shprehet në ashpërsinë, egoizmin, pandieshmërinë, përtacinë, panjerëzinë dhe në përgjithësi në paraqitjen e cilësive tjera të ndryshme negative para të cilëve turpërohet dhe rrënoqethet secili besimtar i ndershëm, i drejt dhe shpirtërisht i fuqishëm. Gati nuk është e nevojshme të përmendet kjo e ndryshkur e zemrave se sa e dëmton dhe nënçmon, kushdo qoftë. E kur është pyetur për ilaç, shërim dhe shpëtim nga gjendja e këtyllë e rëndë, Pejgamberi a.s. me gatishmëri rekomandon që njerëzit të mendojnë shumë për vdekjen e tyre dhe të këndojnë shumë për vdekjen e tyre dhe të këndojnë Kur'an.

Qëndrimi i shumicës së njuerëzve ndaj vdekjes ka qenë gjithnjë i kundër prej atij që duhet, të nevojshmit dhe të dobishmit. Shumica e njerëzve vdekjen nuk e mendojnë asnjëherë ose shumë rrallë, shumica i frikohen edhe të menduarit se një ditë do të vdesin, e disa ky mendim i pengon në vullnetin e tyre për punë, jetojnë dhe flasin sipas logjikës së tyre. Qëndrimi i tillë ndaj vdekjes është trgjik për secilin, sepse vdekja është më se e sigurtë dhe ardhjen e saj as që duhet ta argumentojmë... Dhe, pikërisht për këtë besimtari i mençur duhet sa më shpesh ta kujtojë vdekjen. Kjo do t'i sjellë vetëm dobi, asnjëherë nuk e dëmton. Kjo sigurisht do t'i lirojë nga kurtha e jetës dhe do t'i bindë se është e vlefshme të jetosh në pajtim vetëm me ligjin e Zotit. Shkurtimisht, të kujtuarit shpesh vdekjen është ilaç kundër ndryshkjes së zemrave.

Këndimin e Kur'anit Muhammedi a.s. e rekomandon si ilaçin e dytë kundër ndryshkës së zemrës së njeriut. Ky është ilaç i posaçëm hyjnor, sepse ai është udhëzim, mësim, këshillim, mëshirë, rrugë e drejtë, vërejtje për të gjithë që kanë zemra dhe ndenja. Kur'ani është udhëzim për të devijuarit, mësim për të mençurit, këshillë për të paudhëzuarit, poashtu mëshirë dhe rrugë e drejt për ata që janë pa përvoje dhe moralisht të devijuar. Ky është libër në radhë të parë me përmbajtje morale. Kur'ani është ilaç dhe ngushëllim, ai nxit në meditim, i zgjon dhe forcon ndjenjat më fisnike, i shëron zemrat e ndryshkuara, gjegjësisht pengon që të bëhen të atilla. Kur'ani është shpresë dhe ngushëllim, ushqim shpirtëror dhe ilaç njëkohësisht. Për shkak të të gjitha këtyre Pejgamberi fisnik e rekomandon si mjet të sprovuar për ngritjen morale dhe shërim shpirtëror të të gjithë njerëzve. Sa më parë dhe sa më vigilentë të jemi, aq më tepër do të jemi të fuqishëm dhe më të ngritur me karakter, më fisnik dhe moralisht më të qëndrueshëm. Atëherë ndryshkja e zemrave do të jetë larg nesh, sepse do të jemi njerëz të vërtetë me plotkuptimin e fjalës.

"Shumë mirësi ka në një shtëpi ku lexohet Kur'ani, kurse pak aty ku nuk lexohet".

Ky hadith paraqet edhe një stimulim për besimtarët që të merren me këndimin e Kur'anit. Sepse, Kur'ani është mirësi e plotë, dobi e pakufishme, begati e madhe të cilën duhet ta ketë secila shtëpi muslimane. Kryetari i familjes duhet të kujdeset që në shtëpi të ketë shumë mirësi në çdo aspekt. Para se gjithash, ky është motiv me rëndësi që në familje të ketë harmoni, respekt, punë të përbashkët dhe organizim për të mirën dhe përparimin e të gjithëve. Secili kryetar i ndërgjegjshëm i familjes është i obliguar të angazhohet që në shtëpinë e tij vazhdimisht të sundojë fryma kur'anore edhe të gjithë të jetojnë sipas Islamit të vërtetë, ashtu si e përshkruan Kur'ani.

Kur'ani këndohet në një shtëpi muslimane, nëse aty të gjithë anëtarët e rritur falen, sepse nuk ka namaz në të cilin nuk këndohet Kur'an. Dhe përkundrazi: nëse në shtëpinë e tillë nuk falet, Kur'ani nuk është aspak i përfaqësuar, kjo është familje shumë e dobët muslimane, dhe në të nuk ka mirësi. E për një gjë të tillë do të jenë fajtorë dhe përgjegjës para Zotit, më së shumti prindët, para të gjithëve baba.

Prindët, para gjithë të tjerëve, duhet gjithnjë dhe me sukses të kujdesen që në shtëpinë e tyre gjithnjë të ketë shumë mirësi, që gjithë anëtarët të jetojnë në kënaqësinë e zotit, sepse vetëm mënyra e tillë e jetës është e frytshme dhe shpëtimtare.

"Cilido musliman që shkon në shtrat dhe këndon ndonjë sure nga Kur'ani, All-llahu i Lartmadhëruar do të caktojë mbi të një melek që ta mbrojë që mos i afrohet kurgjë shqetësuese, derisa mos zgjohet".

Nuk është vështirë që në këtë hadith ta hetojmë dëshirën e sinqertë dhe të flaktë të Pejgamberti a.s. që këndimi i Kur'anit të kultivohet, për shkak se kjo bie pushim të qetë dhe të sigurtë gjatë natës, aq të nevojshëm për vazhdimin e jetës dhe punës së përditshme. Çka don të thotë gjumë i rahatshëm, mund të thonë vetëm ata që aq shumë e kërkojnë. E Muhammedi a.s. edhe për këtë rast na rekomandon Kur'anin si mjet të sigurt për qetësim, pa të cilin nuk ka as pushim e as punë të suksesshme.

- "All-llahu ka të afërmit e vet ndër njerëz.

- Kush janë ata të afërm, o Pejgamberi i Zotit? - tha dikush.

- Ata që interesohen për Kur'anin janë të afërmit e Zotit dhe të Zgjedhurit e Tij - u përgjigj ai".

Në këtë hadith Pejgamberi a.s. ka theksuar çka do të thotë rregullisht të këndohet Kur'an. Njerëzit e këtillë - sipas këtij hadithi - i afrohen All-llahut dhe arrijnë pozitë të lartë te Ai. Ata me këtë bëhen të dashurit e Tij, ata te Ai janë të dalluar dhe qëndrojnë në radhët e njerëzve të parë ndaj të cilëve është i kthyer kujdesi i posaçëm i All-llahut. Në grupin e njerëzve të tillë gjithsesi numrohen edhe ata që vetëm e recitojnë Kur'anin, si dhe ata që, përveç kësaj, edhe studiojnë dhe sillen sipas rregullave të tij.

"Lexoni Kur'an, sepse ai në Ditën e Gjykimit do të paraqitet si ndërmjetësues për faljen e gabimeve ndaj tyre që e kanë lexuar!"

Edhe në këtë hadith Muhammedi a.s. rekomandon këndimin e Kur'anit dhe këtë rekomandim e arsyeton me fjalët se Kur'ani në botën e ardhshme do të jetë në rolin e ndërmjetësuesit për faljen e gabimeve recituesve të tij, të cilët diçka gabojnë në këtë botë. Kur'ani pra, atëherë do të paraqitet si mbrojtës dhe shpëtues prej dënimit të rëndë, sepse këtë njerëzit e këtillë e kanë merituar.

Në këtë hadith kemi nxitje të bukur dhe unikate për këndimin e Kur'anit.

"Shtëpia në të cilën këndohet Kur'ani duket te banorët e qiellit, sikurse duken yjet te banorët e Tokës".

Kjo don të thotë se shtëpia e tillë posaçërisht është e çmuar dhe e rëndësishme te i Lartëmadhëruari dhe nuk është si çdo shtëpi tjetër. Në këtë kuptim ekziston edhe hadithi tjetër i cili thotë:

"Ndriçoni shtëpitë tuaja me namaze dhe këndim të Kur'anit!"

Të gjitha hadithet e theksuara dhe të tjerë, të cilët flasin për këndimin, mësimin dhe studimin e Kur'anit, kanë qëllim kryesor që t'u tërheqin vëmendjen njerëzve në Kur'anin si libër i fatit dhe shpëtimit të gjithë njerëzve në të dy botrat.

Këto hadithe kanë kontribuar shumë që Kur'ani jo vetëm të mbrohet nga haresa, por që nga fillimi të jetë objekt studimi i një numri të madh njerëzish të shkencës dhe është përkthyer në shumë gjuhë.

Për këndimin e Kur'anit ekzistojnë edhe mendime të as'habëve të shquar dhe të njerëzve të mëdhenj të Islamit.

Kështu Abdull-llah b. Abbasi, për shembull, thotë:

"Kush këndon Kur'an, nuk do të sillet në rangun më të ulët të jetës, e të mos dijë kurgjë nga ajo që ka ditur përpara".

S'ka dyshim se këtu bëhet fjalë për senilitetin total, të cilin e pengon këndimi i Kur'anit rregullisht. Kjo është e kuptueshme dhe e saktë edhe nga aspekti medicinal, sepse kur këndojmë, posaçërisht përmendësh, qelizat e trurit janë gjithnjë aktive, e kjo bile së paku ngadalëson procesin e senilitetit.

Ngjajshëm është shprehur Abdulmelik b. Umejr:

"Intelegjencën e vet më të gjatë do ta ruajnë recituesit e Kur'anit".

Kur dikush sahabit të njohur Abdull-llah b. Mes'ud ia ka tërhequr vërejtjen pse agjëron pak nafle, ai është përgjigjur:

"Kur agjëroj, dobësohem, e mua më është më i dashur këndimi i Kur'anit".

Saktësinë e pohimeve të lartësuara e ka vërtetuar përvoja e njerëzve që rregullisht kanë kënduar Kur'an.

## **2. GJUNAH ËSHTË TË HARROSH DIÇKA PREJ TEKSTIT TË MËSUAR PËRMENDËSH NGA KUR'ANI**

Për atë se janë gabimtarë i ata që harrojnë së paku diçka prej tekstit të mësuar nga Kur'ani flasin disa hadithe, prej të cilëve posaçërisht dallohen tre:

"Mua më janë paraqitur gabimet e pasardhësve të mi, dhe nuk kam parë gabim më të madh se dikush të mësojë përmendësh një sure ose ajet nga Kur'ani dhe pastaj ta harrojë".

Harresa e lartëpërmendur paraqitet sepse i këndojmë vetëm ato pjesë që i dimë mirë. Kjo ndodh me ata që pak shoqërohen me Kur'anin; njerëzit e këtyllë rrallë ose asnjëherë nuk e falin namazin, sepse namazi, siç është përmendur, nuk mund të mendohet, gjegjësisht nuk vlen pa këndimin e Kur'anit. Namazi është rasti më i mirë dhe më i shpeshtë që gjithë tekstin kur'anor, të cilin e dimë përmendësh, vazhdimisht ta përsërisim dhe ashtu ta mbrojmë nga harresa. Në këtë doemos të ushtrohemi dhe për secilin namaz, sipas mundësisë, të përgatitim tekst të ri. Kjo praksë më vonë nuk do të paraqet kurrëfarë mundimi dhe ne kështu do të jemi të përjashtuar nga kërcënimi të cilin e përmban hadithi i lartëshënuar.

Njerëzit e diciplinar, posaçërisht hafizët gjejnë rast për veti dhe për të tjerët që Kur'anin e mësuar përmendësh ta ruajnë nga harresa. kështu ata shpesh, e posaçërisht për çdo të premtë (xhuma), përsërisin përmendësh, ose duke shikuar në Mus'haf, diçka nga teksti i Kur'anit.

Hafizët në këtë duhet gjithsesi të prijnë. Ata duhet haptas, para publikut të paraqiten në namaz ose ndryshe, duhet Kur'anin edhe vetë çdo ditë ta lexojnë. Ata duhet, pra, më shumë se tjerët të shoqërohen me Kur'anin, dhe vetëm kështu të mbeten hafizë vërtetë të dëshmuar, e jo vetëm me emër, siç janë sot shumica e tyre. Sepse, të jesh hafiz, si është përmendur në njërin prej haditheve të lartësuara, është nder i madh te All-llahu, prandaj hafizët janë të obliguar të kujdesen që tërë jetën atë nder ta ruajnë, përkatësisht të mbeten gjithnjë hafizë të mirë. Ata, sipas kësaj, duhet gjithnjë të jenë vigjilentë për ruajtjen e hifzit.

"Kush e mëson Kur'anin dhe pastaj e harron, Ditën e Gjykimit do të takohet me All-llahun i gjymtë".

Edhe këtu është fjala për qortimin e personit i cili ka harruar të kënduarit e Kur'anit, duke shikuar në tekst ose përmendësh. Për personin e tillë Pejgamberi a.s. në këtë hadith thotë se në Ditën e Kijametit do të jetë me shenjë, e cila do t'i shërbejë si shenjë e nënçmimit dhe hidhërimit të Zotit.

Në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit hasim në këtë hadith:

"Mbani lidhjen, me Kur'anin, sepse, pasha Zotin, Kur'ani ikë më tepër se devja prej litarëve".

Këtu nuk është fjala vetëm për atë që është e zakonshme, shoqërimin e përgjithshëm me Kur'anin, që teksti i tij, si do të mund të mendohej, të shpëtohet nga harresa, por këtu

këshillohemi, se krahas harrimit të tekstit, mund të bëhemi të papërfillshëm ndaj normave të tij. Kjo shkakton largimin gradual, por të sigurt nga jetesa sipas normave islame.

Lidhjet e dobëta me Kur'anin ndikojnë të harrojmë tekstin e tij, përsëri, është gabim ndaj librit të lartësuar të Zotit, që vetes nuk do t'i lejonte asnjë besimtar i ndërgjegjshëm dhe i devotshëm.

Në fund duhet të përkujtojmë se këtu mendohet vetëm në të harruarit e paarsyeshëm të tekstit të mësuar përmendësh, si nga pakujdesia, leximi jo i rregullt etj. Por në rast sëmundjeje, siç është seniliteti, atëherë këtu nuk ka kurrëfarë mëkati.

### **3. PASTRIMI PARA SE TË KËNDOHET KUR'AN**

Rekomandohet të merret abdest me qëllim të kunduarit Kur'an, sepse ky këndim është një prej veprave më të mëdhaja dhe më të mira vullnetare, nëse nuk ka qenë i pastër - siç është vërtetuar edhe me hadith.

Imam-ul-Haramejni thotë se mund të këndojmë Kur'an edhe pa abdest, sepse, dihet, se kështu ka vepruar Pejgamberi a.s. kur ka kënduar Kur'an dhe i është paraqitur dalja e frymave të këqija, ai këndimin e ka ndërprerë derisa kjo paraqitje fiziologjike mos të kalojë, dhe pastaj përsëri e ka vazhduar.

Disa e pohojnë se është rreptësisht e ndaluar (haram) të prekish Mus'hafin me duar të papastërta. Të gjithë pajtohen se është rreptësisht e ndaluar (haram) të kënduarit Kur'an nga personi që është

"xhunub", si dhe duke qenë në kohën e menstruacionit. Shumica pohojnë se është e lejuar të preket Mus'hafi dhe të lexojë edhe personi i cili nuk ka abdest. Kuptohet gjithsesi se më mirë është të prekish Mus'hafin me abdest.

## 4. KU DHE NË ÇFARË POZITË KËNDOHET KUR'ANI?

Sunnet është të këndojmë Kur'an në vend të pastërt. Për këtë më e përshtatshme është xhamia si dhe çdo vend tjetër i pastër, i mbyllur qoftë ose i hapur. Disa mendojnë se nuk është e rekomanduar të këndohet Kur'an në banjo ose në rrugë. Neveviu thotë se, sipas mësimin të shafiut, nuk ka pengesë të këndohet Kur'an edhe në banjo.

Në kohën e sotme, kur në shumë banesa në një lokal janë edhe banja edhe nevojtorja, mund të thuhet se në vende të tilla këndimi i Kur'anit në banjo është rreptësisht e ndaluar (haram).

Është e pëlqyeshme këndimi i Kur'anit ulur, me fytyrë të kthyer nga kibla, i penduar, i qetë, dinjitoz dhe pak kryen e varur. Kurrësesi nuk është e lejuar gjetë këndimit të jemi të veshur pa hije, ose krejtësisht në pozitë të papëlqyer.

## 5. TË SHQIPTUARIT E FJALËS "AMIN"!

Ebu davudi në përmbledhjen e tij bie një hadith në të cilin thuhet se Muhammedi a.s. me zë ka thënë "AMIN" pas leximit të sures Fatiha te fjala "Veladdal-lin". Ndërsa Taberaniu, në përmbledhjen e tij, sjell hadith se Pejgamberi a.s. me atë rast ka thënë tri herë "amin". Bejhekiu përmend hadith se Muhammedi a.s. me atë rast ka thënë fjalët "Rabbigfirli, amin"! Ebu Ubejdeh transmeton një hadith se Xhibrili e ka udhëzuar Muhammedin a.s. të thotë: "amin", në fund të sures Bekare. poashtu, ky dijetar i hadithit transmeton prej Musa b. Xhebelit se ashtu ka vepruar.

## 6. KUR ËSHTË MIRË TË ULIN ZËRIN GJATË KËNDIMIT TË KUR'ANIT?

Neveviu thotë se kjo është mirë kur këndohet pjesë e ajetit ose ajet i tërë në të cilin citohen fjalët e dikujt me të cilit nënçmohet All-llahu xh.sh. ose ndonjë gjë tjetër e shenjtë, për shembull:

"Hebrenjtë thonë: Uzejri është biri i All-llahut..."

"Hebrenjtë thoinë: Dora e All-llahuut është e shtërnguar..."

## 7. PËRSËRITJA GJATË KËNDIMIT

Nuk pengon që më shumë herë të këndohet ajeti i njejtë. Kështu Neveviu dhe të tjerët bien hadith të cilin e transmeton Ebu Dherri se Muhammedi a.s. me një rast tërë natën deri në agim e ka përsëritur ajetin:

"Nëse t'i i dënon ata-robërit e t'u janë, e nëse i falë ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm".

## 8. TË KËRKOSH QË TJETRI TË KËNDOJË KUR'AN

Neveviu thotë se është mirë të kërkosh prej tjetrit të këndoje diçka nga Kur'ani dhe gjatë kësaj kohe me kujdes ta dëgjojmë, nëse ky ka zë melodik. Për këtë ekziston hadith autentik në të cilin thuhet se këtë e ka kërkuar vetë Muhammedi a.s.

## 9. TË KUNDUARIT E KUR'ANIT ME RADHË

Më mirë është të këndojmë Kur'anin me radhë, pa lëshuar kurgjë, pra me atë radhë që është i shkruar Mus'hafi, sepse ajo radhitje ka qëllimin e vet. Kësaj mund t'i shmangemi vetëm ku këtë e

ka bërë edhe vetë Muhammedi a.s. Kështu ai në namazin e sabahut e ka pasur zakon në rekatin e parë të këndojë suren Sexhdeh (e cila fillon në faqen e 14) të xhuzit 21, me fjalët: e në rekatin e dytë suren, insan (e cila fillon në faqen e 17) të xhuzit 29 me fjalët: e të ngjajshme, edhe pse këto dy sure nuk janë njëra pas tjetrës.

Sipas kësaj e lejuar është që mos i këndojmë suret me radhë, përkatësisht ta këndojmë suret me radhë, përkatësisht ta këndojmë suren që është kah fundi para atyre të fillimit, por me këtë lëshohet ajo që është më e mirë. Ndërkaq, të recitosh një sure prej fundit kah fillimi nuk është e lejuar kursesi, siç nuk rekomandohet të këndojmë në një vend nga pak prej më shumësureve, sepse Muhammedi a.s. për këtë ia ka tërhequr vërejtjen Bilalit, duke i thënë që njëren sure ta mbrojtë nëse veç e ka filluar. I pyetur për njeriun i cili prej një sure këndon dy ajete dhe këtë e lë dhe fillon të këndojë nga një sure tjetër, Ibni Sirini është përgjigjur: "Le të mbrohet secili prej jush që me vetëdije mos bëjë gabim të madh"!

## 10. TË DËGJUARIT E KËNDIMIT TË KUR'ANIT

Të dëgjosh kiraetin e Kur'anit, te hanefitë është vaxhib, kurse te shafitë sunnet. Gjatë kësaj kohe duhet lënë bisedën dhe të dëgjohej qetë, me kujdes dhe me përlulje, por edhe nëse nuk e dimë kuptimin e asaj që këndojmë. Çdo sjellje tjetër do të jetë pak a shumë nënçmim i Kur'anit dhe sipas kësaj edhe gjynah.

## 11. SEXHDEJA PAS KËNDIMIT TË KUR'ANIT

Kur këndoje një ajet prej 14 vendeve, të cilët në Mus'hafin janë posaçërisht të shënuara anash (në margjinë), duhet bërë nga një sexhde. Kjo sexhde te hanefitët është vaxhib, kurse te shafiitët dhe të tyjerët është sunnet. Sipas vendeve ku gjenden ato sexhde, hanefitët dallojnë pak prej shafiive dhe të tjerëve. Ky ndryshim qëndron vetëm aty se te hanefitët në suren HAXHXH gjendet një, kurse te shafiitët ka dy vende për sexhde. Ky vend i dytë është pas ajetit të parafundit të asaj sure (në mes të faqës 20 të xhuzit 17). Përveç kësaj në suren SAD (në mes faqes 13 të xhuzit 23) kjo sexhde te shafiitët është mustehab.

Si sexhde të 15-të, disa e shtojnë fundin e sures HIXHR (faqja 16, e xhuzit 14).

Ja ato vende ku është e shënuar sexhdeja:

Ajeti i fundit i faqës 15, të xhuzit 9 sureja ARAF,

Ajeti i dytë i faqes 10, të xhuzit 13, dmth. ajeti 15-të i sures RAD,

I shtati, përkatësisht i teti ajet i faqes 11, të xhuzit 13, dmth. i 49-ti përkatësisht i 50-ti ajet i sures NAHL,

Ajeti i katërt i faqës 12 të xhuzit 15, dmth. ajeti i 108 i sures ISRA,

Ajeti i shtatë i faqës 8 të xhuzit 16, dmth. ajeti 57 i sures MERJEM,

Ajeti i tretë i faqes 13 të xhuzit 17, dmth. ajeti 18 i sures HAXHXH,

Ajeti i pestë i faqes 4 të xhuzit 19, dmth. ajeti 59 i sures FURKAN,

I treti, përkatësisht i katërti ajet i faqes 18 të xhuzit 19, dmth. i 25-ti, përkatësisht i 26-ti ajet i sures NEML,

I katërti, përkatësisht i pesti ajet i faqës 15 të xhuzit 21, dmth. i 15-ti, përkatësisht i 16-ti ajet i sures SEXHDEH,

I teti, përkatësisht i nënti ajet i faqes 13 të xhuzit 23, dmth. i 24-ti, përkatësisht i 25-ti ajet i sures SAD,

I teti, përkatësisht i nënti ajet i faqes 19 të xhuzit 24, dmth. i 37-ti përkatësisht i 38-ti ajet i sures FUSILET,

Në mes të faqës së 7 të xhuzit 27 dmth. ajeti i fundit i sures NEXHM,

Faqja e nëntë e xhuzit 30, dmth. ajeti i fundit i sures INSHIKAK,

Në fund të faqes 17 të xhuzit 30, dmth. në fund sures ALEK.

## 12. KOHA E KËNDIMIT TË KUR'ANIT

Neveviu përmend kohët e zgjedhura për këndimin e Kur'anit dhe thotë se më mirë është të këndohet Kur'an në namaz, pastaj gjatë natës, kurse ndërmjet akshamit dhe jacisë ky këndim

është i pëlqyeshëm (mustehab). Sa i përket ditës, më së miri është të këndohet Kur'an pas sabahut dhe nuk ka asnjë moment që ky këndim të jetë i papëlqyeshëm (mekruh).

prej ditëve më të zgjedhura janë: dhjetë ditët e fundit të ramazanit dhe dhjetë ditët e para të muajit dhulhixhe, ndërsa prej muajve më i zgjedhur është ramazani.

### **13. KOHA E FILLIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË KËNDIMIT TË KUR'ANIT**

Është e parapëlqyeshme që të fillojmë të premtën, kurse ta përfundojmë në prag të ditës së enjte. Ibnu Ebi Davudi transmeton prej hazreti Othmanit se ai kështu ka vepruar. Më mirë është këndimi i hatmes të përfundohet në fillim të ditës ose natës, sepse Darimi transmeton hadithin se Sad b. Ebi Vekkasi ka thënë: "Kur kënduesi përfundimin e hatmes e përputh me fillimin e natës, për atë melekët luten për falje derisa mos të gdhijë, nëse këtë e përputh me fillimin e ditës, për atë melekët luten për falje derisa të errët".

Ky përfundim në fillim të ditës mund të jetë në dy rekatet e sabahut, kurse ai në fillim të natës në dy rekatet e sunnetit të akshamit. Ibnu Mubareku thotë se është e rekomanduar në kohën e dimrit të përfundojmë në fillim të natës, kurse verës në fillim të ditës.

14. Të agjuarit në ditën e hatmes

Sunnet është të agjëruarit në ditën e hatmes. Këtë e bie Ebu davudi në përmbledhjen e vet të hdithit, e si transmetues përmend një grup tabiinësh. Njëkohësisht thuhet se është e rekomanduar që në ditën e hatmes të prezantojnë shokët dhe anëtarët e familjes së kënduesit.

Taberaniu bie një hadith nga as'habi Enes se ky i ka tubuar anëtarët e vet të familjes dhe ka bërë dua kur e ka përfunduar këndimin e tërë Kur'anit. I përmenduri Ebi Davud sjell prej hakem b. Utejbës se pas tij ka porositur Muxhahidi të i cili ka qenë Ibnu Ebi Umameh. Kur ka arritur, i kanë thënë se pas tij e kanë dërguar, sepse duan të bëjnë hatme dhe të bëjnë dua, pasi që duaja pranohet me rastin e hatmes. Muxhahidi, një prej tabiinëve, thotë se ata janë tubuar me rastin e hatmes dhe shton se me atë rast vjen mëshira e All-llahut.

## 15. TEKBIRI PAS KËNDIMIT TË DISA SUREVE

Është e rekomanduar (mustehab) të këndohen tekbiere pas përfundimit të këndimit të sures Duha dhe ashtu me rradhë deri në fund të Mus'hafit. Kjo është e rekomanduar prej eksperteve për kiraet nga Meka. Shafi'u thotë: "Nëse e lëshoj tekbinin, do të humbi njëren prej tradhitave të Pejgamberit të All-llahut". Hamedani transmeton prej Bezzuit se cila ishte arsyeja e këtij tekbiri. Muhammedit a.s. i është i ndërprerë shpallja dhe pastaj është shpallur sureja Duha dhe me atë rast Muhammedi a.s. e ka thënë tekbinin. Ai tekbir përbëhet prej fjalëve "All-llahu ekber".

Kapacitetet në kiraet, të cilët nuk shërbejnë me këtë tekbir, me këtë rast, thonë se kjo mund të shërbente si arsyetim për t'i shtuar Kur'anit diçka që nuk i takon, posaçërisht nëse ai tekbir shqiptohet rregullisht.

## 16. DUAJA E HATMES

Sunnet është ta bëjmë duanë pas përfundimit të këndimit të tërë Kur'anit. Për këtë ka hadith të Muhammedit a.s. më përmbledhjen e Taberaniut dhe të tjerëve, i cili thotë:

"Kush e bën hatme Kur'anin do ta ketë duanë të pranuar te All-llahu".

## 17. PAS PËRFUNDIMIT TË NJJËRËS, FILLIMI I HATMES TJETËR

Sa të përfundojmë njërën, sunnet është ta fillojmë hatmen tjetër. Për këtë gjendet hadith në përmbledhjen e Tirmidhiut e të tjerëve:

"Për All-llahun vepër më e dashur është që pas njëres hatme menjëherë ta fillojmë tjetrën".

Në përmbledhjen e Darimiut gjendet hadith në të cilin thuhet se Muhammedi a.s. pas përfundimit të sures NAS e ka pasur zakon të vazhdojë me këndimin e sures Fatiha dhe BEKARE deri te:

dhe, pasi e ka bërë duanë e hatmes, është ngritur.

## **18. NDËRPRERJA DHE VAZHDIMI I KËNDIMIT TË KUR'ANIT PËRSËRI**

Nëse këndimin e Kur'anit e ndërpresim për shkak të ndonjë pyetje ose bisedës e cila ka të bëjë me këndimin, nuk do ta shqiptojmë përsëri istiadhen. Nëse përsëri e vazhdojmë këndimin, istiadha do të përsëritet nëse bëhet fjalë për bisedë të rëndomtë, qoftë edhe për pranimin e selamit.

## **19 KËNDIMI I SURES IHLAS TRI HERË**

Ahmed bin Hambeli ka ndaluar që me rastin e hatmes të këndohet surja IHLAS tri herë. Ndërkaq - vëren Sujutiu - praktika e njerëzve është e kundërt. Disa mendojnë se ajo praktikohet për shkak se ekziston hadith në të cilin thuhet se vlera e kësaj sure është e barabartë me një të tretën e Kur'anit, dhe me atë përsëritje dëshirohet të arrihet sevapi i hatmes. Përveç kësaj, gjatë këndimit të Kur'anit mund të bëhet ndonjë gabim, dhe me këtë përsëritje ajo përmirësohet.

## 20. PËR SA KOHË DUHET TË KËNDOHET KUR'ANI?

Kur është fjala për shpejtësinë e këndimit të Kur'anit, muslimanët e parë kanë pasur shprehitë e tyre të ndryshme. Kështu dihet se ka pasur njerëz të cilët për 24 orë kanë bërë nga dy hatme, e disa nga një. Kur Musliman b. Muhrak ia ka bërë me dije h. Aishes se ka njerëz që tërë natën bëjnë nga 2-3 hatme, ajo është përgjigjur se në këtë nuk beson dhe ka shtuar: "Unë jam ngritur dhe tërë natën e kam vështruar Pejgamberin a.s. Ai atëherë e kishte zakon të këndoje suren BEKARE, ALI IMRAN dhe NISA". Kur haste në ajet që tregonte ndonjë lajm të gëzueshëm, i bënte dua. E kur haste në ajet që shprehte kërcënimin, ai përsëri bënte dua dhe kërkonte mbrojtjen e All-llahut".

Pastaj ka pasur njerëz, të cilët për dy net kanë bërë nga një hatme, ndërsa disa këtë e kanë bërë në afat prej tri netësh. Kjo është mirë, thot Sujutiu në veprën e njohur "El-itkan". Shumë dijetarë islamë kosiderojnë se nuk është mirë që hatmeja të këndohet më shkurt prej kësaj kohe. Këtë e kanë gjykuar as'habët Abdull-llah b. Omer, Abdull-llah b. Mes'ud dhe Muadh b. Xhebel, përkatësisht janë deklaruar që koha më e shkurtë të jetë tri ditë. Seid b. Mundhir ia ka përkujtuar Muhammedit a.s. se e këndon Kur'anin për tri ditë, dhe ai këtë e ka lejuar me vërejtjen: "Nëse mundësh". Ka pasur njerëz të cilët këndimin e Kur'anit e kanë përfunduar për 4,5,6 dhe 7 ditë. Kjo është mesatare dhe më e mirë, e kështu kanë vepruar shumica e as'habëve dhe të tjerëve.

Në përmbledhjen e haditheve të buhariut dhe Muslimit qëndron hadithi, të cilën e transmeton Abdull-llah b. Omer, i cili thotë se Muhammedi a.s. i ka thënë që Kur'anin ta këndojnë për një muaj. Kur ky e ka lajmëruar se mund ta këndojnë edhe më parë, Muhammedi a.s. i ka thënë ta

këndojë për dhjetë ditë. E kur ky e ka lajmëruar se mundet edhe më parë, Pejgamberi i All-llahut i ka thënë ta këndojë për shtatë ditë, por jo edhe më parë.

Një as'hab tjetër (Kajs b. Ebi Sa'saah) e ka pyetur Muhammedin a.s. për sa kohë ta këndojë Kur'anin, dhe ky ia ka caktuar afatin prej 15 ditësh. Kur Kajsi e ljmëron se mundet edhe më parë, Muhammedid a.s. ia cakton 7 ditë.

Pastaj përmendën as'habët të cilët Kur'anin e kanë përfunduar për 8 ditë, për 10 ditë, pastaj për një muaj dhe dy muaj, e disa bile edhe për kohë më të gjatë. Disa rekomandojnë dy hatme në vit, nëse njeriu nuk mundet më tepër.

Ekziston deklaratë e Ebu Hanifës në të cilën ai thotë: "Kush e këndon Kur'anin çdo vit, nga dy herë, ai e ka plotësuar detyrën e vetë, sepse Pejgamberi i All-llahut e ka kënduar Kur'anin dy herë para Xhibrilit atë vit që është shpërngulur në ahiret..."

Disa, ndërkaq, mendojnë se nuk është mirë (mekruh) të bëjmë hatme për më tepër se katërdhjetë ditë pa shkak të arsyeshëm, sepse Abdull-llah b. Omer e ka pyetur Muhammedin a.s.: Për sa kohë ai e këndon Kur'anin. Ai është përgjigjur se këtë e bën për katërdhjetë ditë.

Dijetari i njohur i haditheve, neveviu, mendon se kohëzgjatja e këndimit të hatmes mvaret prej vetë personit. Kjo, pra, sipas mendimit të tij, është çështje individuale. Kështu, për shembull, personi të i cili këndimi i Kur'anit do të nxisë meditim të thellë dhe ndenja të tjera, mund të kënaqet me atë që këndon dhe të përpiqet ta kuptojë sa më mirë atë. Nëse dikush, përsëri, është i zënë me punë profesionale, përkatësisht punë për të mirën e përgjithshme, ai mjafton të këndojë nga Kur'ani aq sa ky këndim nuk do t'i shkaktojë ndonjë ç'rregullim në punën e tij të përditshme e

të dobishme. Nëse nuk i pengon në punën, le të lexojë sa më shumë që mundet, duke pasur kujdes me atë rast mos i kalojë në mërzi dhe lexim prozaik.

## **21. SEVAPI NGA KËNDIMI I KUR'ANIT PËR TË VDEKURIT**

Ebu Hanifja, Ahmedi dhe Maliku janë të mendimit se sevapi që fitohet me këndimin e Kur'anit i arrin personit të vdekur, ndërsa shafitët konsiderojnë se nuk arrin. Këta të fundit thirrën në ajetin:

"(...dhe njeriu do të ketë vetëm atë që e ka merituar...")

## **22. KUR'ANI SI BURIM I TË ARDHURAVE PËR JETESË**

Nuk është e rekomanduar (mekruh është) që ta përdorim Kur'anin, dmth. këndimin e tij si burim i të ardhurave për jetesë. Ekziston, ndërkaq, një hadith në të cilin thuhet: "Kush këndon Kur'an, le të vijneata që do të këndojë Kur'an dhe me anë të tij do të kërkojnë ndihmë nga njerëzit".

## **23. PRANIMI I DHURATËS PËR TË MËSUARIT E KUR'ANIT TË TJERËVE**

Sa i përket pranimit të dhuratës për t'ia mësuar dikujt Kur'anin, këtu janë të ndara mendimet e dijetarëve islamë në tri grupe. Kështu disa marrjen e dhuratës nuk e lejojnë. Ndër të tillët janë Zuhriu dhe Ebu Hanife. Tjerët kët lejojnë, por pranimi i dhuratës mos kushtëzohet. Këtë mendim e përfaqësojnë Hasan basriu, Sha'biu dhe Ibni Sirini. Atau, Maliku, Shafiu dhe të tjerët lejojnë pranimin e dhuratës, nëse të dy palët bëjnë marrëveshje si duhet.

Në favor të lejes flasin disa hadithe autentike.

## **24. MËNYRAT E NDRYSHME TË RESPEKTIMIT TË MUS'HAFIT**

1. Të ngrihesh në këmbë, kur paraqitet dikush me Mus'haf, disa e konsiderojnë risi të palejueshme (bi'datun sejjieh), me arsyetim se kjo nuk është praktikuar në shekullin e parë të Islamit. Ndërkaq, shumica e dijetarëve islamë këtë ngritje e lejon dhe e konsideron të pëlqyeshme (mustehabb), sepse me këtë dëshirohet të tregohet respekt, e jo nënçmim.
2. Të puthish Mus'hafin don të thotë të tregosh respekt ndaj librit të Zotit. Prandaj shumica absolute e dijetarëve islamë atë gjest e konsiderojnë të pëlqyer.

3. Rekomandohet ta parfimosim Mus'hafin dhe ta vendosim në raft, por është e ndaluar (haram) ta vemë nënkrye, sepse kjo është gjest nënçmimi. Zerkeshiu konsideron se është respektivisht e ndaluar t'i shtrisë këmbët drejt Mus'hafit.
4. Është e lejuar të zbukurosh Mus'hafin, p.sh. me arghjend, me qëllim që të tregohet respekt dhe nder.
5. Bejhekiu në Sunenin e vet shënon se velid b. Muslim ka thënë: "E kam pyetur malikun për zbukurimin e Mus'hafit me argjend. Ai na nxorri një Mus'haf dhe tha: -Na ka transmetuar babai im nga babagjyshi se ata e kanë tubuar Kur'anin në një përmbledhje në kohën e Othmanit dhe atë e kanë zbukuruar me argjend si ky ose ngjajshëm".
6. Edhe prarimi (të larët me ar) është i lejuar, por, thonë, vetëm kur është fjala për Mus'hafin pronar i cilit është grua, përkatësisht me të cilin shërbehen vetëm gratë.
7. Nëse për shkak të vjetërsisë duhet disa fletë ose tërë Mus'hafin ta heqim nga përdorimi, ai material nuk guxon të vihet në vend ku mund të binte ose mund të shkilet, siç është e lejuaras të shklyhen fletët. Fletët e tilla më mirë është të digjen, sikur që ka vepruar në kohën e tij Othmani. Disa nuk e lejojnë as këtë, kurse Neveviu konsideron se kjo është e papëlqyer (mekruh). Në disa vepra të hanefive qëndron se fletët e vjetëruara të Mus'hafit nuk duhet të digjen, por të mbulohen me dhe. Tjerët, ndërkaq, i bëjnë vërejtje edhe kësaj, sepse, thonë ata, atëherë paraqitet mundësia që ai material të shkilet.

8. Njëri prej dijetarëve klasik islam Ibnu-l-Musejeb thotë se nuk është mirë të shqiptohen në deminutiv fjalët të cilat për respekt i përshkruhen All-llahut xh.sh. si p.sh. mus'hafth dhe xhamizë etj., sepse - tërheq vërejtjen ky njeri - çka i takon All-llahut është madhështore.

## **25. SHITBLERJA E MUS'HAFIT**

Mendimet e shumë dijetarëve islamë të kohërave më të hershme, duke filluar nga tabiünët, të cilët kanë të bëjnë me shitjen dhe blerjen e Mus'hafit, janë të ndryshme. Kështu disa konsiderojnë se nuk është e preferuar Mus'hafin as ta shesish, as ta blejsh. Tjerët, ndërkaq, mendojnë se nuk pengon të blerit, por nuk lejojnë shitjen, se këtu punohet për shitëblerjen e kopjeve të Mus'hafit. Më praktik është mendimi i tretë. Përndryshe kjo pyetje sot më edhe nuk shtrohet, kurse dhurimi i Mus'hafit konsiderohet gjithnjë vepër e mirë.

## **26. ME ÇFARË SHPEJTËSIE TË KËNDOHET KUR'AN?**

Ekzistojnë tri lloje të shpejtësisë së këndimit të Kur'anit: MESATARE, E NGADALSHME dhe E SHPEJTË.

Shpejtësinë mesatare gjatë këndimit të Kur'anit e rekomandojnë, në përgjithësi, të gjithë ekspertët e kiraetit, ndërsa Abdull-llah b. Mes'ud, ndër të tjera, thotë:

"Mos e lexoni Kur'anin duke shpejtuar, e as mos e këndonit si këngë!"

Prandaj më mirë është Kur'anin ta këndojmë me shpejtësi mesatare, me ndërjegje të plotë, duke i zbatuar të gjitha rregullat e texhvidit, të cilat kanë të bëjnë me shqiptimin e disa tingujve dhe fjalëve, si dhe në të lidhurit në mes vedi të tingujve dhe fjalëve, duke pasur kujdes të duhur në rregullat për pushim në fjalë të caktuara, si dhe për vazhdimin e këndimit pas pushimit.

Përveç kësaj, gjatë këndimit të Kur'anit duhet pasur kujdes që zëri dhe melodia të jenë në arabishten e pastër, të zbukuruar dhe sipas mundësisë bile pak në të qajtur.

## **27. ME ÇFARË SHPEJTËSIE KANË KËNDUAR DISA NGA EKSPERTËT E NJOHUR TË KIRAETIT?**

Prej eksperteve të njohur të kiraetit Kur'anin e kanë kënduar:

- a. me TAHKIK (dmth. ngadalë): Hamza dhe Vershi,
- b. me HADR (dmth. shpejtë): Ibnu Kethiri, Ebu Xhaferi, Amri dhe Jakubi,

c. me Tedvir (dmth. me shpejtësi mesatare): shumica e ekspertëve, saktësisht të gjithë përveç të lartëpërmendurve. Edhe ekspertët që këtë shkathtësi e kanë ligjeruar, e kanë proklamuar shpejtësinë mesatare të këndimit të Kur'anit.

## 28. SA TË KËNDOHET NGA MUS'HAFI?

A është më mirë të këndohet nga Mus'hafi ngadalë dhe më pak ose shpejtë më shumë - për këtë ndër ekspertët e kiraetit ka mendime të ndryshme. Ata që mbështesin mendimin se është më mirë të këndojmë shumë thirren në hadithin të cilin e transmeton Abdull-llah b. Mas'udi, i cili thotë:

"Kush këndon një shkronjë nga Kur'ani, do të ketë sevapë, e sevapi është dhjetfish".

Këtë hadith e bie Tirmiziu në prëmbledhjen e vet dhe e konsideron atentik. Ekspertët e tjerë mbështeten në një variant tjetër të hadithit të njëjtë:

"Kush këndon një shkronjë nga Kur'ani, do të ketë për secilin shkronjë nga Kur'ani, do të ketë për secilën dhjetë sevape".

Të njëjtët ekspertë thirren në faktin se h. Othmani e ka kënduar gjithë Kur'anin në një rekat, duke i përmendur me atë rast mendimet e shumë pararendësve të tjerë.

Është e saktë dhe mendim i respektuar të cilin e kanë konfirmuar shumica absolute e dijetarëve të hershëm dhe të vonshëm islamë se këndimi i ngadalshëm, me meditim, bile sa do pak le të jetë është më i mirë prej këndimit të shpejt, bile edhe shumë le të jetë, për arsye se qëllimi kryesor i

këndimit të Kur'anit është meditimi, vetëmësimi dhe të mësuarit të tjerët, si dhe sjellja dhe të jetuarit sipas tij. Vendim të prerë këtij mendimi mund t'i gjejmë në deklaratat e Abdull-lla b. Mes'udit dhe Abdull-lla b. Abbasit r.a. I pyetur për dy njerëz njëri prej të cilëve e këndon në namaz të njejtë vetëm suren BEKARE, kurse tjetri suren BEKARE dhe ALI IMRAN, Muxhahidi është përgjigjur se më mirë është ai që e ka kënduar vetëm suren BEKARE. Prandaj dijetarët e hershëm islamë e kanë përsëritur deri në agim vetëm një ajet, sikur që e ka bërë edhe vetë Muhammedi a.s. Disa thonë:

"Kur'ani është shpallur që sipas tij të veprohet, e këndimin e tij pranoni si veprim"!

Muhammed bin ka'b el-Kurejdhî e ka pasur zakon të thotë se tërë natën deri në mëngjes e këndon vetëm, Idha zulzileti-erdu" dhe "El Kariatu", duke i përsëritur dhe meditar, dhe se më tepër ka parapëlqyer t'i këndojë vetëm këto sure se sa të këndojë tërë Kur'anin me shpejtësi. Një dijetar tjetër i kiraetit ka thënë: "Sevapi për këndimin e Kur'anit ngadalë dhe me përsiatje është më madhështor dhe më i vlefshëm, ndërsa sevapi për këndim të shumtë është i shumëfishtë. I pari është si një njeri i cili shpërndan një stoli të çmuar me vlerë të madhe ose liron një rob shumë të shtrenjtë, ndërsa i dyti është sikur ai që shpërndan shumë të madhe paresh ose liron më tepër rob me më pak vlerë". Gazaliu thotë: "Këndimi i qartë është i bukur jo vetëm për përsiatje, por tingëllon më këndshëm edhe për joarabin i cili nuk e kupton domethënien e Kur'anit, sepse ajo është më afër respektimit dhe më tepër ndikon në zemër".

Disa, ndërkaq, bëjnë dallim ndërmjet këndimit të qartë dhe të ngadalshëm të Kur'anit, dhe thonë se këndimi i ngadalshëm duhet kur është në pyetje mësimi dhe ushtrimi, ndërsa qartësia duhet kur punohet për përsëritjen dhe gjetjen e rregullave.

## 29. KËNDIMI I KUR'ANIT ME ZË DHE NË VETE

Sa i përket ngritjes, përkatësisht uljes së zërit dhe këndimit në vete të Kur'anit, gjenden hadithe të cilat flasin edhe për njëren edhe për tjetrën mënyrë të këndimit. Këtu në këtë kuptim do t'i përmendim vetëm dy hadithe:

"All-llahu nuk i ka lejur askujt çka i ka lejuar Pejgamberit: zërin e bukur që me këtë në mënyrë melodike dhe me zë të këndojnë Kur'an".

"Kush këndon Kur'an me zë është sikur ai që jep sadaka haptas, e kush e këndon Kur'anin në vete është sikur ai, i cili fshehurazi jep sadaka".

Këto dy hadithe Neveviu i përshtat në atë mënyrë dhe thotë se është më mirë këndimi me zë për shkak se këndimi i tillë kërkon më shumë mund, sepse dobia e tij kalon edhe në dëgjuesit, e prek recituesin, e çon në përsëritje etj.

Disa thonë se është më mirë me zë të këndohet në një pjesë, kurse në pjesën tjetër në vete, kur është pa ndërprerë mund të nxitë bezdi, ndërsa këndimi me zë - lodhje.

## 30. TË KËNDUARIT NGA MUS'HAFI

Të këndosh nga Mus'hafi është më mirë se sa këndimi përmendësh, sepse shikimi në Mus'haf gjatë deklamimit është ibadet. Ky është mendimi i dijetarëve të hershëm dhe të vonshëm islamë, i

cili bazohet në disa hadithe. Ka një mendim të vetëm, sipas të cilit është më mirë të këndohet Kur'an përmendësh, sepse kështu mundet më mirë e më shumë të mendohet sesa duke shikuar në Mus'haf. Pas gjithë kësaj që u tha duhet theksuar se këtu fjala është për këndimin jashtë namazit dhe nuk duhet harruar vlerën e këndimit të Kur'anit përmendësh, pra vlerën e hivzit - si është theksuar në më shumë hadithe.

## 31. ISTIADHA

Istiadha është tekst i posaçëm të cilin e shqiptojmë para këndimit të Kur'anit, si dhe në raste tjera. Sipas haditheve dhe sipas njerëzve më të shquar të kiraetit, teksti më i zgjedhur i istiadhës është:

"I mbështetem All-llahut nga djalli i mallkuar".

Gati i njejtë tekst, përndryshe, gjendet edhe në Kur'an dhe atë si pjesë e ajetit 98 të sures NAHL, e ai ajet është:

"Kur të dëshirosh të lexosh Kur'anin, mbështetu te Perëndia që të të shpëtojë nga djalli i mallkuar"!

Si i tillë, është pranuar jo vetëm nga kapacitetet e kiraetit por edhe nga të gjithë juristët islamë, në radhë të parë nga Ebu Hanifja, Shafiu, Ahmed b. Hanbeli etj.

Për tekstin e njëjtë flet hadithi i cili gjendet në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit, e në të cilin thuhet se para Pejgamberit a.s. janë grindur dy njerëz, dhe njëri ka fyer tjetrin aq i hidheruar sa që

është skuqur. Në atë u ka thënë Muhammedi a.s.: "Unë e di një tekst të cilin kur dikush prej jush do ta shqiptonte, do t'i shkante hidhërimi, dmth. kur do të thoshte:

Hadithin e cituar e bie Ebu Ja'la në Musnedin e tij, pastaj Ahmed b. Hanbeli, Nesaiu, Ebu davudi dhe Tirmiziu.

## **32. A DUHET ISTIADHA TË SHQIPTOHET ME ZË OSE NË VETE?**

Të gjithë ekspertet e mëdhenjë të kiraetit, konsiderojnë se istiadhën duhet shqiptuar me zë dhe atë në çdo rast kur këndohet Kur'an. Në veprën e tij "Elxhami" Ebu Amër Ibnu-l-Ala thotë: Unë nuk njoh kurrfarë mospajtimi për të shqiptuarit me zë të istiadhës: kur duhet të fillohet këndimi i Kur'anit, kur duhet për të të ligjërojmë dhe tjerët t'i mësojmë, pra të këndohet istiadha gjatë tërë Kur'anit. Përrjashtim bën versioni që transmetohet prej nafiut dhe Hamzës. I pyetur: si e keni shqiptuar në Medine istiadhën, Ibnu-l-Mesibi është përgjigjur se ata istiadhën nuk e kanë shqiptuar as me zë as pa zë. Ata, vërtet, aspak nuk e kanë shqiptuar istiadhën. Për mësuesin e kiraetit, Nafiun thonë se istiadhën e ka shqiptuar në vete, kurse bismil-lahin me zë para fillimit të këndimit të sureve dhe ajeteve të krejt Mus'hafit ndërsa për mësuesin Hamza thuhet se istiadhën dhe bismil-lahin i ka shqiptuar me zë para këndimit të Fatihasë, e pastaj istiadhën e ka kënduar në vete, gjatë këndimit të krejt Mus'hafit.

Duhet theksuar se shqiptimi me zë i istiadhës gjithsesi është më mirë se ta thuash në vete, sepse shqiptimi me zë është një lloj i përjetimit solemn të aktit të këndimit, si është rasti me telbijen në

haxh dhe tekbin gjatë Bajramit. Përveç kësaj, dëgjuesit me rastin e këndimit heshtin dhe nuk u kalon asgjë nga recitimi, që nuk ndodhë kur istiadha shqiptohet në vete.

istiahdës jasht dhe në namaz. Në rastin e dytë istiahdën duhet shqiptuar në vete, sepse ata që falën pas imamit heshtin prej fillimit të namazit. Për atë se istiahdën në namaz a do ta këndojmë me zë ose pa zë, mendimet janë të ndara, por shumica mendojnë se duhet shqiptuar në vete pa marrë parasysh se Kur'anin me atë rast a do ta këndojmë me zë ose jo. Kësaj i përmbahen edhe ekspertët e fik'hut - Ebu Hanife dhe Ahmedi.

Istiahdha shërben si pastrim simbolik i gojës nga fjalët e pamatura që ndoshta deri atëherë janë thënë, pastaj si përgatitje për këndimin e fjalëve të All-llahut të Lartmadhëruar. Me istiahdën ne pranojmë se vetëm i Lartmadhëruari mund të na mbrojë prej armikut të padukshëm dhe dinak siç është djalli... Prandaj istiahdha shqiptohet para e jo pas këndimit të Kur'anit dhe në këtë janë kompakt të gjithë ekspertët e kiraetit.

### **33. NDARJA, PËRKATËSISHT NGJITJA E ISTIADHËS ME TEKSTIN QË VIJON**

Ekspertet e kiraetit konsiderojnë se është në rregull edhe të ndalurit pasi ta shqiptojmë istiahdën edhe bashkangjitja e istiahdës tekstit që vijon. kjo, pra, i është lënë të zgjadhë kënduesi. Disa eksperte mendojnë se është mirë të ndalemi pas shqiptimit të istiahdës, por është edhe më mirë atë ta shqiptojmë të bashkangjitur me bismil-lahin dhe pastaj të ndalemi.

## 34. A ËSHTË SHQIPTIMI I ISTIADHËS I REKOMANDUAR APO ËSHTË I DOMOSDOSHËM?

Shumica absolute e dijetarëve të tefsirit dhe fik'hut janë të mendimit se shqiptimi i istiadhës është i rekomanduar (mustaheb) dhe atë si në namaz poashtu edhe jashtë namazit. Vetëm disa individë mendojnë se ky shqiptim është i domosdoshëm (farz), duke iu referuar ajetit i cili flet për këtë, ku thuhet: "...kërko mbrojtje!..."(festeidh!...), pra është imperativ. Këta shkojnë edhe më tutje, e thonë se nuk vlen namazi i atij që nuk e shqipton istiadhën. Ndërkaq, shumicva absolute konsideron se ai urdhër ka të bëjë vetëm me Muhammedin a.s. ndërsa për të tjerët është vetëm e rekomandur.

Shumica absolute e eksperteve të fik'hut ndër të cilët janë: Shafiu, Ebu Hanife, Muhammed b. Hasan dhe Ahmed b. Hanbel, thonë se istiadha është e rekomanduar në namaz për shkak të këndimit të Kur'anit, e jo për shkak të namazit, ndërsa Ebu Jusufi mendon se është e rekomanduar për shkak të namazit, prandaj duhet ta shqiptojë edhe ai që falet pas imamit, edhe pse nuk do të këndoje nga Kur'ani.

## 35. BISMIL-LAHU

Ky është shqiptimi i fjalëve:

"Në emër të All-llahut, Bëmiruesit të përgjithshëm, Mëshiruesit!"

Ekspertët e kiraetit, kur është fjala për ndarjen e dy sureve me bismil-lah ose në ndonjë mënyrë tjetër, përkatësisht kur punohet për bashkangjiten e dy sureve kanë mendime të ndryshme. Kështu Ibn Kethiri, Asimi, Ebu Xhaferi, kaluni dhe Vershi, sipas Isfahaniut, i ndajnë me bismil-lah çdo sure, përveç sures ENFAL dhe BERAHEH. Hamza, ndërkaq, i bashkangjet nga dy sure pa e shqiptuar bismil-lahin, ndërsa prej transmetuesit të tij Halefit ekzistojnë dy mendime: të bashkangjiturit dhe të ndalurit pas përfundimit të njëres sure, por pa e ndërprerë frymën (që në texhvid profesionalisht quhet s e k t). Ndërkaq, shumë më i fortë është mendimi për bashkangjitje. Ebu Amri, Ibnu Amiri dhe Vershi, sipas Ezrekit, poashtu i bashkojnë dy sure pa shqiptimin e bismil-lahut.

Shumë gjenerata të mëvonshme, të cilat lidhen për Hamzën, Ebu Amrin, Ibnu Amirin, Jakubin ose Vershin nga dëshira bëjnë s e k t në mes të sures MUDETHTHIR dhe KIJAMEH, INFITAR dhe MUTAFFIFIN, FEXHR dhe BELED, ASR dhe HUMEZEH, dmth. ndërmjet përfundimit të të parës dhe fillimit të dytës nga suret e përmendura. Kjo ndodh kështu për arsye se është shumë e pavolitshme të ngjiturim mbarimine të parës me fillimin e sures së dytë, duke marrë parasysh kuptimin, i cili me atë rast do të ishte i paprekshëm dhe i palogjikshëm. Sikur mos ishin të ndara me bismil-lah, secila nga këto dy sure, do të kishin nga dy fjali të cilat kurrsesi nuk mund të qëndrojnë njëra pas tjetrës. Kjo do të dukej kështu:

"Ai është i vetmi të cilit duhet t'i druajmë dhe Ai është i vetmi falës. Beto hem në Ditën e Kijametit".

"...dhe hyn në xhennetin Tim! Beto hem në këtë qytet..."

"Atë ditë - pushteti i tërë është vetëm i perëndisë. Mjerë për ata që kur masin mangësojnë..."

"...dhe të cilët i rekomandojnë njëri-tjetrit durim. Mjerë për çdo përqeshës-shpifës!"

Duhet theksuar se ekspertët e lartpërmendur në kiraet bëjnë s e k t vetëm në rast se ndërlihdin këndimin e të dytës për këndimin e sures së parë, përndryshe ato dy sure i ndajnë me deklamimin e bismil-lahit. Poashtu kur është fjala për fillimin e këndimit dhe atë prej fillimit të ndonjë sure.

Bile edhe ata që ndërmjet dy sureve e recitojnë bismil-lahun, këtë e lënë, kur pas mbarimit të sures ENFAL menjëherë e këndojnë suren BERAHEH (TEVBE). Ata veprojnë njësoj edhe kur këndimin e fillojnë me këtë të fundit. Lëshimin e bismil-lahut para kësaj sureje ekspertët e kiraetit e arsyetojnë me njërin nga këto dy shkaqe: sepse është shpallur me qëllim të nxitjes së luftës së muslimanëve kundër idhujtarëve, ose për shkak se nuk janë të sigurtë a është në të vërtetë sure e posaçme, pas sures ENFAL. Disa mundohen me analogji të lejojnë këndimin e bismil-lahut kur këndimin e vet e fillojnë edhe në këtë sure, pa marrë parasysh shkakun për të cilin bismil-lahu nuk është i theksuar në fillim të saj. Megjithatë, shumica absolute është kundër një praktike të tillë.

Disa, përsëri, mendojnë: Nëse dikush këndimin e fillon me këtë sure, por para saj thotë istiadhën dhe bismil-lahin ngjitur, duke pritur prej saj mirësi (muteberriken bil-besmele) - shpresohet se kjo nuk do të pengojë, por është e lejuar të veprojë ashtu kur dëshiron të këndojë ndonjë ajet, por jo prej fillimit të sures. Ajo çka nuk bën është që kënduesi ta këndojë vetëm suren Enfal, e pastaj menjëherë të fillojë këndimin e sures së ardhshme, përkatësisht suren Beraeh me bismil-lah.

Ndërkaq, do të jetë më mirë dhe në pajtim me Ixhmain dhe Mus'hafin, nëse kënduesi nuk do të thotë bismil-lahun, pa marrë parasysh atë se prej ku ka filluar ta këndojë suren Beraeh.

Të gjithë ekspertët e kiraetit lejojnë bashkimin, të ndalurit pa frymë (sekt) dhe të ndalurit e rëndomt (wakf) në përfundimin e sures ENFAL dhe menjëherë pastaj ta fillojmë suren BERAHEH. Mospërkimi në mendime që ekziston ndërmjet ekspertëve të kiraetit, e i cili ka të bëjë me dy sure dhe bismil-lahun në mes tyre, nuk vlen vetëm për suren ENFAL dhe BERAHEH, por edhe për çdo dy sure tjera, pa marrë parasysh a i këndojmë me radhë njëren pas tjerës ose lëshojmë një sure në mes tyre. Kështu për shembull është e lejuar ta themi ose jo bismil-lahun, nëse mbarimin e Fatihasë e bashkojmë me fillimin e sures Ali Imran, përkatësisht mbarimin e kësaj sure me fillimin e sures En-am.